



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njesia Org Org. Jedinica Org Unit	02
Nr. Prot. Dok. Prot. Prot. No.	05-1380
Nr. faqeve Br. stranica No. pages	- 2 -
Data: Datum: Date:	13/03/2020
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Ured Generalnog Sekretara / Office of the Secretary General

Prishtinë, 12/03/2020

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7 / 01 Mars 2019), dhe në pajtim me nenin 5 (paragrafi 5.4. c) të Rregullores 2001/19 për Degën e Ekzekutivit, dhe në zbatim të masave të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me menaxhimin e situatës epidemiologjike lidhur me Koronavirusin Covid 19, të ndërmarra më 11 mars 2020 në mbledhjen e ekzekutivit, si dhe në zbatim të rekomandimeve të Komitetit për Monitorimin e Sëmundjeve ngjitëse në Kosovë, Ministria e Shëndetësisë, nxjerr:

Qarkore për Informim të institucioneve Shëndetësore Publike dhe private në Republikën e Kosovës Nr. 04 /2020

Të nderuar përfaqësues të institucioneve Shëndetësore Publike dhe private në Republikën e Kosovës,

1. Të kufizohet rreptë lëvizja e shoqëruesve dhe familjarëve të pacientëve, si dhe prezenca e personave të pa uniformuar në ambientet e urgjencës/emergjencës dhe në institucionet spitalore.
2. Në të gjitha institucionet shëndetësore të vendit (publike dhe private), të kenë të përgatitura dhoma të veçanta për rastet e dyshimta (posaçërisht në Klinikën Infektive të QKUK-së, si dhe në institucionet tjera spitalore të vendit).
3. Të realizohet kontrolli maksimal dhe inspektimet në të gjitha institucionet shëndetësore të vendit (publike dhe private)
4. Në të gjitha institucionet shëndetësore të vendit (publike dhe private), të shtohet kontrolli i brendshëm profesional në baza ditore duke implementuar rekomandimet e instancave të larta të Kosovës
5. Të rritet në maksimum përkujdesja e stafit mjekësor dhe jo mjekësor ndaj higjienës personale dhe institucionale
6. Të aplikohen nga personeli shëndetësor masat mbrojtëse konform udhëzimeve të OBSH të ECDC-së, të përditësuara nga IKSHPK
7. Të vendosen materialet informuese dhe edukative për parandalimin e COVID-19 në institucionet shëndetësore, dhe në institucionet tjera publike dhe private - nga përgjegjësit e tyre
8. Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare (përfshirë gjithë qendrat e mjekësisë familjare në vartësi të saj), Spitalet Rajonale, si dhe ambulancat dhe spitalet private ti raportojnë informatat rreth rasteve të rënda klinike mbi baza ditore direkte (sipas udhëzimeve) dhe me mjetet më të shpejta të Institutet Rajonale të Shëndetësisë Publike
9. Institutet Rajonale të Shëndetësisë Publike do t'i përpunojnë të dhënat dhe varësisht nga ecuria epidemiologjike raportojnë menjëherë Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike me mjetin më të shpejtë të komunikimit dhe dorëzojnë raportet javore të kompletuara në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike.
10. Marrja e mostrave për konfirmim laboratorik do të bëhet vetëm te pacientët me simptome klinike të bazuara në definim të rastit në Klinikën Infektive të QKUK.

11. Personeli i Klinikës Infektive të QKUK i dërgon mostrat për testim laboratorik dhe raporton për të gjitha rastet e hospitalizuara duke e plotësuar pyetësorin përkatës.
12. Rekomandohet shmangie e udhëtimeve në vende të cilat janë me rrezik të lartë dhe të mesëm, në përputhje me listën e Organizatës Botërore Shëndetësore.
13. Të përforcohet pjesëmarrja e vullnetarëve të Kryqit të Kuq dhe vullnetarëve tjerë , në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, në të gjitha vendkalimet kufitare.

Qarkorja i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Departamenti Ligjor;
- Të gjitha institucioneve Shëndetësore Publike dhe private;
- Kryqit të Kuq;
- Arkivit të MSH.

